

BESIMTARI

Gazetë mujore fetare-politike-kulturore. Botues: Shoqata Bamirëse Islame
Vitet I i botimit, Korrik 2007 Nr3. Çmimi 20 lekë. www.gazetabesimtari.com



Pack: Shqipëria myslimane
s'është problem për BE

Olsi Jazexhi

Fq 2

Srebernica dhe
paqeruajtësit antimuslimane

Selim Gokaj

Fq 3

Karla Del Ponte
ne perkrahje te Serbise
kunder paveresise se Kosoves

Hysen Kazazi

Fq 4

Ceremoni madheshtore ne
medrezene Haxhi Sheh Shamia

Selim Gokaj

Fq 6

VAKUFI, PASURI E
TE GJITHE MUSLIMANEVE

Hadi Bushati

Fq 7

VDEKJA NA VJEN PREJ
KADARESE SE TILLE

Halil Ibrahim

Fq 7

FEJA ISLAME NUK ËSHTË ORGANIZATË TERRORISTE



dhe i dyshuar do te vihej tashme ne qender te kronikave dhe analizave ne te gjitha mediat boterore. , duke bere qe bota islame te kishte tashme nje litar ne qafe, te cilin qendra dhe shtete te fuqishme antimuslimane mund ta terhiqnin sipas deshires dhe shijeve te tyre antimuslimane. Emertimi terrorist po perdoret per te etiketuar fene islame, kurse emertimi i dyshuar u jep te drejten atyre qe e shpiken kete term te arrestojne dhe te mbajne ne burgje pa afat muslimanet duke i privuar nga e drejta per t, u gjykuar nga nje trup gjykues. Model per veprime te tilla eshte burgu i Guantanamo, ku muslimanet po mbahen ne arrest me vite te tera. Te gjithë muslimanet, sot, e shohin vehten

Për terrorin dhe terrorizmin ndaj muslimaneve dhe fesë islame, që nuk dihet se kur do të marrë fund, vazhdon të jepet informacion me një ritëm të pandërprerë dhe përherë edhe me kercënues, duke bërë që, në opinjonin publik, të behen pyetje tepër shqetësuese. Po krijohet idea se bota ka hyrë në një luftë fetare, ku në shinjester është vënë feja islame. Ka shumë mundësi që kjo të jetë e vertetë, sepse, sot, të gjitha vatrat e luftes janë ndezur në vendet me popullsi muslimane, ku, në emër të një civilizimi më vlerë të kufizuara, po ushtrohet dhunë dhe po përgjaken pa meshirë shtete dhe individë muslimane, që po penalizohen vetëm se janë të perkatesise islame. Shtabet e errta, ku hartohen planet kundër muslimaneve, bëjnë të pamundshëm që të fshehin qëllimet e tyre dhe ta kalojnë topin në fushën e kundërshtarit aq sa, kur shpërthen një bombe atentati, ajo u faturohet muslimaneve duke sjellë pastaj veprime represive kundër muslimaneve në hapësira ku jetojnë popullsi muslimane, që fatkeqesisht janë shumë të zbuluara përballë këtij genocidi shumëplanësh. Kështu ka ndodhur me ngjarjet e 11 shtatorit, me hedhjen në erë të disa pallateve në Rusi, që pasuan me pushtimin e Afganistanit, Irakut cecenise, ku masakrat kundër civileve të pafajshëm nuk njihen kufi. Në një intervistë të dhënë për revistën "Vepra" veprimtari i njohur islam në Angli, Muadh Ganushi, do të deklaronte; "11 shtatori ka qenë një katastrofë për muslimanet në Perëndim, sepse deri në atë ditë, veprimtaria islame zhvillohej e qetë dhe po ecte shumë përpara. Kurse, pas kesaj dite u hapen të gjitha dyert e shërrit për muslimanet" Duke shfrytëzuar këto skenare, zyra shumë të fuqishme dizinformimi, si ishte zyra pranë Departamentit të Shtetit, që realizoi një dizinformim tronditës në të gjithë botën, Opinjonit publik iu serviren dy emertime mbi të cilat do të ngrihej ngrehina nga ku do të fillonte sulmi i pamëshirshëm ndaj botes islame. Emertimi terrorist

te pasigurte dhe te kercenuar nga nofka shume e rrezikshme e terroristit. Perpjekja per te barazuar Islamin me terrorizmin ka dy qellime kryesore; Se pari, shtetet antimuslimane duan te justifikojne masakrat dhe sulmet qe po bejne ndaj botes islame ne emer te nje demokracie nen gryken e armeve. Se dyti, keto agresore antimuslimane duan te krijojne mbeshetje ne opinjonin publik te vendeve te tyre dhe me gjere, qe keto masakra t, I bejne edhe me te egra dhe dhuna ndaj muslimaneve te njohje vetem spiralen e rritjes. . . Bota po behet deshmitare e nje dhune te ashpër ne te gjitha hapësirat ku jetojnë muslimane dhe viktime e kesaj dhune kane rene edhe veprat e kultit te fese islame si; xhamia, medreze dhe qendra te tjera islamike qe jane djegur dhe shkaterruar. Ajo qe te shqeteson eshte, se kjo masaker ndaj institucioneve muslimane behet ne vende qe pretendojne se jane tribune e demokracise. Rralliten si qendra te tilla masakrash Australia, Zelanda e Re, Anglia, SHBA, Danimarka dhe vende te tjera qe duket se Islami po ua prish gjumin. Ndersa, radio e njohur Holgen, ne Danimarkë, ben thirrje te hapur per t, I vrare muslimanet mbi te cilet sot po behet denocid qe mund te konkuroje me ate qe u be dikur ndaj hebrejve ne LDB. Kjo dhune ka marre permasa te tilla sa, senatori amerikan Tagredo do te deklaronte se SHBA duhet te bombardoje qendrat e shenjta muslimane, duke perfshire Meken dhe Medinen, kur ato ta ndiejne vehten te kercenuar. Kjo deklarate solli nje indinjate ne tere boten muslimane, sepse tashme rreziku per muslimanet kishte arritur majat. Por, edhe para ketyra ngjarjeve, feja islame eshte goditur pa nderprerje ne Perendim, duke i paraqitur muslimanet si terroriste, xhamitevende sekrete dhe te rrezikshme dhe Islamin nje kercenim per Perendimin. Mediat jane ato qe e bindin qytetarin perendimor per portretin e fese islame si fe terroriste dhe shume e rrezikshme. Ajo qe te shqeteson eshte se

Vijon faqe 4

Eurodeputetja përgjigjet për deklaratën e Bush Pack: Shqipëria myslimane s'është problem për BE

“Zoti Bush është kuptueshëm i shqetësuar me aktet terroriste të 11 shtatorit dhe mendoj se donte të rrëfente diçka miqësore për Shqipërinë, duke mos e njohur realitetin atje”.



Ky është reagimi i eurodeputetes Doris Pack, lidhur me deklaratën e presidentit të SHBA, i cili e cilësoi Shqipërinë si një vend ku myslimanët jetojnë në paqe. Në një intervistë për gazetën, Pack hedh poshtë edhe zërat se identiteti i Shqipërisë mund të jetë problem për BE-në. Sipas saj, Shqipëria myslimane nuk është parë si një problem për integrimin në strukturat evropiane.

Znj.Pack. Ndërsa Presidenti Xhorxh W. Bush do të vizitojë Shqipërinë në fund të kësaj jave, deklarata e tij që Shqipëria është një vend ku myslimanët rrojnë në paqe, ka irrituar disa njerëz. Disa shkruen në shtypin tonë kanë shkruar se deklarata e Bushit do të cenojë integrimin e Shqipërisë në BE, pasi na ka portretizuar si myslimanë. Mendoni se një gjë e këtillë është e drejtë?

Njerëzit nuk duhet të definojnë vendet sipas besimit. Zoti Bush është kuptueshëm i shqetësuar me aktet terroriste të 11 shtatorit dhe mendoj se donte të rrëfente diçka miqësore për Shqipërinë, duke mos e njohur realitetin atje. Asnjëri nuk duhet të shohë diçka të këtillë të lidhur me integrimin në BE. Shqipëria prej shekujsh është vend evropian, qytetarët e saj janë evropianë besimet e tyre fetare ndahen në myslimanë, ortodoksë dhe katolikë. Mesa di unë, shumë njerëz janë të pafe pas diktaturës së Enver Hoxhës, që ndaloi praktikat fetare totalisht. **Në një të përditshme në Tiranë, një gazetar i bazuar në Bruksel, deklaroi se një numër parlamentarësh evropianë i kanë thënë atij se një nga arsyet pse Shqipëria nuk mund të bashkohet me BE-në, është anëtarësia e saj në Organizatën e Konferencës Islamike. Është e vërtetë që BE-ja është e pakënaqur me anëtarësinë e Shqipërisë në organizata si puna e OKI-së?**

Unë nuk njoh ndonjë koleg që mund të ketë përmendur diçka të këtillë. Në asnjë rezolutë të Parlamentit Evropian nuk është përmendur diçka e këtillë. Mbaj mend që në fillim të viteve nëntëdhjetë, Presidenti Berisha kërkoi për anëtarësim në OKI. Por, kjo nuk është ratifikuar asnjëherë në Parlamentin shqiptar, dhe pjesëmarrja e zyrtarëve shqiptarë në takimet e tyre ka qenë e nivelit të ulët. Po përse duhet të mërzitemi ne? Shqipëria mund të shërbejë si një sy evropian aty, për të ndihmuar ata të kuptojnë Evropën.

Ekziston një tendencë në mesin e disa qarqeve në Shqipëri, që deklarojnë se një nga arsyet pse Evropa Perëndimore nuk e do integrimin e

intervistoi
Olsi Jazexhi

Shqipërisë në BE është trashëgimia jonë myslimane. A ka Komuniteti Evropian ndonjë problem me 70% të shqiptarëve që janë myslimanë?

Jo. Kjo është absurde. Trashëgimia juaj është trashëgimia jonë gjithashtu. Dikush duhet të lexojë Kadarenë për të kuptuar dhe pëlqyer Shqipërinë. Anëtarësimi i Shqipërisë

varet vetëm në arritjet e saj politike, në përmbushjen e të gjithë kushteve si çdo vend tjetër që kërkon të anëtarësohet në BE. E njëjta gjë vlen për Bosnje dhe Hercegovinën, Serbinë, Malin e Zi, Kosovën dhe Maqedoninë. Ndërsa sa për Turqinë, ka mendime të ndryshme në BE, për shumë arsye që nuk mund t'i bisedojmë këtu.

Po mbi Islamit? A i sheh Bashkimi Evropian myslimanët si të huaj, apo si pjesë e identitetit të tij të ri kulturor?

Siç them edhe më lart, myslimanët evropianë janë qytetarë si të gjithë besimtarët dhe jo besimtarët dhe kultura e tyre është një nga bazat e kulturës sonë evropiane.

Tashmë dihet nga të gjithë që në Shqipëri dhe Kosovë ekzistojnë institucione të korruptuara dhe krim i organizuar. Megjithatë ka një tendencë në mesin e disa qarqeve në Shqipëri dhe Kosovë të atribuojnë emrin e keq të shqiptarëve në Perëndim me identitetin tonë mysliman dhe Islam. Është e vërtetë një gjë e këtillë?

Është e vërtetë që në Kosovë, në Shqipëri, por edhe në disa vende të BE-së operojnë shumë organizata kriminale të lidhura me shqiptarët. Ky është fatkeqësisht një fakt dëshpërues që cenon imazhin e shqiptarit në përgjithësi. Por, kjo nuk lidhet në asnjë mënyrë me identitetin fetar.

A është BE-ja e shqetësuar për liritë dhe të drejtat fetare në Shqipëri dhe Kosovë?

Jo, aspak. Problemet tuaja qëndrojnë gjetkë.

Cila është këshilla juaj që shqiptarët duhet të ndjekin për t'ju bashkuar BE-së?

Të ndalojnë luftërat e pafundme politike, të lehtësojnë dhe përmirësojnë jetën e qytetarit të thjeshtë, të ndjekin rregullat që Shqipëria pranoi kur nënshkroi Paktin e Stabilizimit-Asocimit që do të thotë ta implementojnë atë të luftojnë rrjetet kriminale, t'i japin qytetarëve të paktën një kartë identiteti etj.

Deklaratë për Shtyp

FMSH mirëpret presidentin Bush dhe shqetësohet nga aludimet rreth BE-së në shtyp 08-qershor-07

Forumi Musliman i Shqipërisë ka përcjellë me simpati deklaratimet e presidentit George W. Bush për vizitën e tij të ardhshme në Shqipëri, dhe cilësimin e shqiptarëve si 'njerëz myslimanë që mund të jetojnë në paqe'.

Vizitën e kryetarit të vendit që më së shumti ka bërë dhe po jep përkrahje të fuqishme për çështjen kombëtare shqiptare, e konsiderojmë një ngjarje të shënuar në historinë e kombit dhe i urojmë atij mirëseardhjen.

Forumi Musliman i Shqipërisë i shpreh falenderimet e sinqerta SHBA-ve dhe vendeve të Bashkimit Evropian për mbështetjen e qartë dhe të palëkundur që po i japin Planit Ahtisari për statusin përfundimtar të Kosovës.

Nga deklaratimet e presidentit George Bush del krejt e qartë që përkatësia myslimane e shumicës së popullit shqiptar në Shqipëri dhe në trojet etnike shqiptare nuk përbën kurrfarë pengese për integrimin euro atlantik të tyre. Megjithatë, disa qarqe islamofobe me ndikim në median elektronike dhe të shkruar, në shoqërinë civile dhe në institucionet shtetërore, kanë arritur të krijojnë alarme në opinionin publik shqiptar duke krijuar idenë që identiteti islam i shqiptarëve është problem.

Islamofobët e vendit tonë si rezultat i kësaj propagandë kanë qënë të suksesshëm që të marginalizojnë besimtarët myslimanë, duke i diskriminuar ata dhe mbajtur jashtë universiteteve, administratës shtetërore, dhe në disa raste edhe administratës së biznesit privat.

Diskriminimi kundër myslimanëve sot në Shqipëri shihet qartë ndërsa ata nuk lejohen që të ndërtojnë një xhami në qendër të Tiranës (por falen në rrugë), ndërkohë që një gjë e këtillë nuk ndodh me bashkatdhetarët e tyre të krishterë. Në Shqipëri sot kemi të bëjmë me një diskriminim 'par excellence' të shumicës.

Forumi Musliman i Shqipërisë konstaton me habi se në mënyrë paradoksale disa zëdhënës të islamofobisë në Shqipëri po nxitojnë t'i japin mesime presidentit Bush për deklaratimet e tij pro-muslimanëve shqiptarë, duke i dhënë të kuptojë se 'nuk i di mirë gjërat'. Populli thotë: i zoti e shet, tellalli se jep.

Një pikë kulmore në këtë rast përbëjnë edhe direktivat e dhëna nga Ervin Baku në shkrimin e datës 7 qershor 2007 në Gazetën Shqip, me titull 'feja e shqiptarit është shqiptaria'. Në shkrimin e tij Ervin Baku insiston që shqiptarët duhet të proklamojnë origjinën e tyre të krishterë pasi islami sipas tij nuk është feja e shqiptarëve. Kujt duhet t'ia proklamojnë këto gjera shqiptarët? Evropianëve dhe amerikanëve nga shkencëtarët e të cilëve kanë mësuar dhe mësojnë historinë e tyre? Madje nga ata kanë mësuar që edhe përpara se të ishin të krishterë, kanë qënë popull pagan. Mos vallë duhet proklamuar kjo fe meqë është më e lashtë.

Ervin Baku ndjehet i terrorizuar nga që Shqipëria aderon në Konferencën Islamike. Sipas tij 'aderimi dhe vazhdimi i qënies sonë në Konferencën e Vëndeve Islamike përbën një handicap tejet të konsiderueshëm drejt Europës së Bashkuar. Kjo nuk do t'u thuhet kurrë zyrtarisht politikanëve shqiptarë nga interlokutorët e tyre evropianë..

Forumi Musliman i Shqipërisë nuk është i prirur të besojë që Ervin Baku është një person më konfident, se përfaqësuesit zyrtarë të shtetit shqiptar me të cilët Bashkimi Evropian ka nënshkruar marrveshjen e Stabilizimit Asocimit. Mesa dimë ne, Shqipërisë nuk i është vënë kurrfarë kushti për t'u larguar nga Konferenca Islamike si kusht për nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje. Në qoftë se pjesëmarrja e Shqipërisë në Konferencën Islamike do të ishte kaq problematike, kërkesa e parë për largimin e saj do të kishte ardhur që në datën 11 shtator 2001. Por për çudi edhe tani që presidenti Bush viziton Shqipërinë një kërkesë e këtillë nuk bëhet, por në të kundërt presidenti Bush lavdëron myslimanët e Shqipërisë.

Forumi Musliman i Shqipërisë do të dëshironte që të kishte një prononcim të qartë nga Brukseli për aludimet që Ervin Baku ka bërë në lidhje me zyrtarët më të lartë të këtij institucioni dhe për përkatësinë myslimane të shqiptarëve.

FORUMI MUSLIMAN I SHQIPËRISË
TIRANË

SREBERNICA DHE PAQERUAJTESIS ANTIMUSLIMANE



Pak dite me pare, ne te gjithë ekranet e botes, u pane pamje te dhimshme te nje tubimi te papare me pare, ku teleshikuesit ndoqen nje ceremoni mortore ku ne toke ishin me qindra arkivole, brenda te cileve ishin viktimat e nje krimi qe logjika njerezore e ka te veshtire ta pranoje . Ishin pamje nga qyteti boshnjak i Srebrenices ku po u falej xhenazja ketyre viktimave te pafajshme qe u vrane vetem, sepse ishin muslimane Qeveria boshnjake ngriti nje memorial ne kujtim te ketyre njerezve te pafajshem duke e bere njekohesisht kete memorial nje akuze te rende kunder atyre qe e planifikuan kete masakre gjakatare kunder popullsisë muslimane te Bosnjes. Srebernica vazhdon te mbetet nje shembull i frikshem i kasaphanes boshnjake dhe nga ana tjetër akuze e rende per paqerujtesit hollandeze qe u bene pjesemarres ne vrasjen e mbi 11000 civileve muslimane duke u hapur rruge trupave serbe dhe duke u dhene arme dhe mjete qe ata ta kishin me te lehte vrasjen e civileve te pambrojtur muslimane ne Srebernice. Ajo qe te shqeteson shume eshte se pikerisht keto ushtare, qe u bene pjese e krimit, qeveria hollandeze i nderoi me medalje trimerie duke ne bindur se misioni i vertete i ketyre paqerujtesve ishte vrasja e muslimaneve se Hollanda eshte e njohur per ndjenjat e saj antimuslimane. Per krimin qe u bene Srebernice, informacionet vazhdojne te shtohen dhe keshtu e verteta po behet prone e opinjonit publik boteror. Iformacionet e fundit

tegojne se kancelarite e vendeve perendimore kishin dijeni te plote per kete masakre para se ajo te ndodhte dhe nuk moren masa qe ta ndalonin ate, sepse lufta ne Bosnje kishte si qellim kryesor te ndalonte rritjen ne numur te popullsisë muslimane te cilen e shikonin si rrezik per perhapjen e muslimaneve ne Evrope. Mbi 3 milion muslimane boshnjake u larguan nga vendi i tyre nga lufta, 200000 ishte numuri i te vrareve dhe me mijra ishin te plagosurit. 80000 gra e vajza boshnjake u perdhunuan nga egersirat serbe gjate kesaj masakre, Kjo masakre nuk mund te quhej lufte, sepse civilët e pambrojtur ishin viktimat qe e pesuan nga ky zjarr qe e ndezi Bashkesia Nderkombetare te cilin e monitoroi deri sa ai u ndal . Per ironi, ne ceremonine e memorialit ne Srebernice ishte edhe Karla Del Ponte e cila eshte modeli i qendrimit qe faktori nderkombetar ka mbajtur dhe po mban ndaj krimeve qe u bene ne Bosnje. E krijuar per te gjykuar kriminelet e luftes ne ish Jugosllavi, ne fakt Gjykata e Hages ka bere te pamunderen qe te barazoje viktimen me agresorin, qe "ndeshja" te perfundoje ne barazim duke e vene vehten me keto veprime ne anen e agresoreve Ata, qe vrane e shfrosen mijra muslimane ne Srebernice, jane figura te njohura dhe Haga u silltet rrotull dhe nuk i ve ne bankon e te akuzuarve, sepse duket se ato jane te lire nga nje amnisti e pashpallur e faktorit nderkombetar per keto bisha me fetyre njeriu. Rotko Mlladic dhe

Radovan Karaxhic i bejne me dore Hages nga larg. Kurse ne kete gjykate antimuslimane po gjykohen gjeneralet me te mire te ushtrise boshnjake si; Sefer Halilovic dhe Rasim Delic qe u bene tmerri i ushtrise te serbeve te Bosnjes duke u shkaktoan disfata te pallogaritshme. Po i akuzojne per krime kunder njerezimit heronjte e muslimaneve te Bosnjes, ne nje kohe qe nuk eshte zbuluar asnje varr masiv serb ne Bosnje. Kuptohet se aty lufte behej dhe te drejten per t, u mbrojtur muslimaneve ua ka garantuar vete Allahu Famelarte ne Kuranin e Madhnueshem Gjykata e Hages tashme ka dale jashte loje dhe eshte teper pak e besueshme, gje qe arriti kulmin, kur ajo me nje vendim te turpshem e nxori te lare Serbine nga genocidi qe ajo ushtroi mbi popullin musliman te Bosnjes. Por mbijetesen dhe shpetimin e popullit musliman te Bosnjes nuk e kishte ne dore Bashkesia Nderkombetare. Ishte BOTA MUSLIMANE ajo qe e shpetoi popullin muslimane te Bosnjes nga kthetrat e krimineleve serbe e cila dergoi ne kete hapësire muslimane miljarda dollare dhe mijra luftetare, qe po te mos ishte paqja e Dejtonit, ne Bosnje nuk do te kishte kembe serbi. Fundi i luftes, muslimanet i gjeti me nje ushtri me 200000 luftetare qe nuk te falnin ne fushebetjeje. Ajo ishte nje Vietkong i ri me te cilen nuk mund te matej askush. OKB, duke e njohur pergjegjesine dhe fajin e saj te rende per ate qe ngjau ne Bosnje, ne vitin 2000 kerkoi falje publike e cila do te mbese e pamjaftueshe, sepse per sa OKB veproji ne Bosnje, ajo operonte me nje strategji te qarte e cila, nga fillim deri ne fund, ishte nje strategji thellesisht antimuslimane

Ajo qe ndolli ne Bosnje tregon se muslimanet vazhdojne te jene te kercenuar. Ngjarjet, qe ne po i jetojme ne vitin 2007, tregojne se ne Boten Islame tashme nuk ka vetem nje Bosnje. Afganistani, Iraku, skenaret me autobomba te mbetura ne tentative dhe politikane qe dalin ne ekrane me fetyre egersirash, ku lexohet qarte urrejtja per muslimanet, tregojne se per Boten Islame po vijne kohe te veshtira . Por, e ardhja e Islamit nuk eshte deshire njerezore as deshire e politikës. Feja islame eshte dhurate hyjnore per te gjithë njerezimin dhe goditjet nga jashte dhe nga mrenda bashkesise islame nuk mund ta heqin Islamit nga rruga edhe pse ne asionet kunder tij, qendra te fuqishme kunder fese islame fusin ne loje edhe kriminelet te tille si; presidentin e Pakistanit, Musharaf i cili sulmon xhamite muslimane qe i pergjak me gjakun e medrezistevë qe mesojne librin e Allahut Famelarte, KURANIN E MADHNUESHEM.

SELIM GOKAJ

Shkoder, me 12 korrik 2007

Shoqata Bamiresë Shkoder, Shoqata e Intelektualeve Muslimane "Kultura Islame", dega Shkoder, Forumi Musliman Shqiptar dhe Klubi Kulturor Drita, ne emer te anetaresise muslimane qe ato perfaqesojne, permes kesaj deklarate, me rastin e vendosjes se Memorialit ne Srebernice i cili u kushtohet viktimave te pafajshme muslimane, qe u masakruan nga paramilitaret kriminele serbe ne bashkepunitim me forcat paqerujtesë hollandeze, qe ishin nen komanden e OKB, shprehin ngushellimet e tyre qe u drejtohen familjeve muslimane ne te gjithë Bosnjen ndaj te cileve u ushtrua nje genocid qe ua kalon krimeve qe ka bere njerezimi ndonjehere. Vellezerve muslimane te Bosnjes martire, i bejne me dije se dhimja e juaj eshte edhe dhimja e jone, , fatkeqesia juaj eshte edhe fatkeqesia jone, vuajtja juaj eshte edhe vuajtja e jone, sepse krimet dhe masakrat qe u bene ne Bosnje, jane plage per te gjithë muslimanet e te gjithë botes. Gjithashtu keto krime jane pjese e krimit te madh qe vazhdon te behet sot ne hapësirat ku jetojne muslimane. Ne jemi te bindur se populli

musliman i Bosnjes ishte dhe eshte shume paqedashes dhe nuk e ka profesion luften si serbet dhe kroatet qe vrane, masakruan dhe perdhunuan me qindra mijra muslimane dhe muslimane ne Bosnjen e pambrojtur.

Ne jemi te bindur se drejtësia do te triumfoje mbi kriminelet dhe ato qe i nxiten dhe i mbeshteten per te kryer masakrat mbi muslimanet e pafajshem. Ajo qe ndodhi ne Bosnje ne vitet 1992 deri ne vitin 1995 ishte nje sprove per muslimanet e Bosnjes qe Allahu i

Madherisem ua dergoi qe te shikonin pozicionin ku ato ishin dhe eshte kjo sprove e ashper qe i beri ata te reflektonin dhe te rritnin perkushtimin per fene islame, duke i bere te gatshem te perballojne sprova te tjera qe jemi te bindur qe nuk do te mungojne.

**Shoqata Bamiresia Islame Shkoder
Shoqata Intelektualeve Islame Shqiptare
Kultura Islame dega Shkoder**

**Forum Musliman Shqiptar
Klubi Kulturor Drita Shkoder**

Shkoder me 12 korrik 2007

DEKLARATE

KARLA DEL PONTE NE PERKRAHJE TE SERBISE KUNDER PAVERESISE SE KOSOVES



Kur forcat e NATOS bombarduan ish-Jugosllavine dhe me pas larguan trupat ushtareke serbe nga Kosova, te shumte ishin ata qe menduan se sundimi i Serbise ne Kosove kishte marre fund dhe pavaresia per Kosoven tashme do te kalonte nga nje ender ne nje realitet. Mbi keto parashikime, shqiptaret si mrenda hapesires kosovare dhe po ashtu ne hapesira te tjera te banuara nga shqiptare, ndertuan, konturet e nje Kosove te pavarur qe me vone do te pasonte pa tjetër bashkimin e saj me Shqiperine, sepse, ne fakt, tashme kufiri ne mes te Kosoves dhe Shqiperise faktikisht nuk ekzistonte me. Por, ngjarjet qe pasuan largimin e ushrise serbe nga Kosova dhe instalimin e forcave nderkombetare, nen nje sigel te cuditshme UNMIK, treguan se deshira per nje Kosove te pavarur ishte larg nga realiteti per nje Kosove te pavarur, sepse ne vijen e frontit kunder pavaresise se Kosoves nuk u rralliten vetem shtete, qe historikish kane qene dhe jane ne krah te Serbise kunder Kosoves, ku violine e pare eshte Rusia ortodokse e Vladimir Putinit, por ne betejen kunder Pavaresise se Kosoves flamurin, e mori ne dore edhe prokurorja e pare e Gjykates se Hages, Karla Del Ponte, e cila, me deklaraten e saj kunder Pavaresise se Kosoves, u rrezua nga piadestali ku e kishte vene detyra e saj per te gjykuar kriminelet e luftes qe sollen ate kasaphane kunder njerezve te pafajshem ne hapesiren Ish-Jugosllave ne te cilen krimet me te renda u bene kunder muslimaneve, sidomos ne Bosnje dhe ne Kosove. Kryeprokurorja e Gjykates se Hages beri nje deklaratë publike ka tha se Pavaresia e Kosoves duhet shtyhet deri ne momentin kur te arrestohen kriminelet qe gjakosen muslimanet ne Bonje, Radovan Karaxhic dhe Ratko Milladic qe ne fakt sillen te lire sikur te kishin bere heroizma dhe jo krime qe

dalin jashte fantazise se nje njeriut normal E thene haptas, Karla e vogel sa nje buburrece, por qe demin e bente madh sa nje tigreshe e kaloi Pavarsine e Kosoven ne nje zgjidhje drej infinitit, ne horizont te te cilit eshte Kosova si pjese e Serbise. Ky arsyetim qendron, sepse kriminelet e lartpermendur nuk arrestohen pikerisht se ata jane te mbrojtur nga marreveshetje nderkomtaresh qe ata kriminele nuk duhet te gjykohen, sepse pa tjetër Milladic dhe Karaxhic dine shume dhe mund t, I vene padronet e tyre ne pozite te veshtire Ka shume mundesi qe ato jane me imunitet edhe nga Marreveshetja e Dejtonin ne shkembim te nje pushimzjarri nga forcat serbe te Besnjes. Por, Karla e vogel italiane, qe sherrin e ben te madh, ka treguar se ka nje alergji per ato qe luftuan per Pavaresine e Kosoves kunder forcave ushtarake serbe duke bere perpjekje dhe veprime qe te barazoje viktimat me kriminelet. Nga nje strategji e tille e kane pesuar heronjte e betejave qe beri UCK kunder forcave paramilitare serbe qe po masakronin popullsin e pafajshme ne Kosove Tashme opinjoni publik e di mire se si u realizuan levizjet e Fatmir Limajt nga Kosova ne Hage dhe anasjelltas, levizje qe perfunduan me pafajsine e zotni Limajt ku roli i Karles kryeprokurore ishte percaktues por kete farce gjygesore qe kompromenton dhe rrezon per toke drejtesine qe premtion kjo gjykate nderkombetare. Eshte pikerisht italia Karla, qe e shfrytezton detyren per te derguar ne Hage nje hero tjetër te Kosoves Martire, i cili eshte

komandanti Ramush Haradinaj. Haga e liroi, sa i liruari me kusht t, I bente disa sherbime me shume faktorit nderkombetar se Kosoves. Dhe pasi "Filmi"perfundoi, u ndegjua perseri thirrja urdheruese e Del Ponte. E cila eshte dora e hekurtqe e ka lene z. Haradinaj pas hekura te burgut te Hages me shpresen per te dale i pafajshem, Por duhet pranuar se eshte veshtire qe ai ta shohe lirin per sa kohe qe ne kete gjykate drejton Zonja e hekurt antikosovare

E verteta eshte se sot po shtohen me shpejtesi portrete si; Karla Del Ponte qe po i ve gure nen rrota realizimit te Pavaresise se Kosoves, duke e rritur numurin e reve mbi qiellin e Kosoves i cili nga nje rendese e tille resh mund te sjelle nje stuhi qe do te lage edhe ato qe punuan kunder Pavaresise se Kosoves.

Jemi shume te bindur se nga nje stuhi i tille, nuk do te shpetoje pa u lagur, ka mundesi me shume se te tjeret, edhe Kryeprokurorja e Gjykates se Hages, Karla Del Ponte, e cila, misionin per te gjykuar kriminelet e luftes ne Ish- Jugosllavi po e realizon kokeposhte, duke peshkuar viktimat per t, I vene ne banke te te akuzuarve se bashku me kriminelet dhe vrasesit e tyre. zoja Karla harron se veprime te tilla kane nje kosto te larte ku ata qe do te paguaj me shume se te tjeret, do te jene pikerisht ata qe organizojne farsa te tilla ne emer te nje drejtesie tashme tejet te pavertete.

HYSEN KAZAZI
Shkoder, me 15 korrik 2007

Vijon nga faqja 1

edhe ne Shtepine e Bardhe Islami po, trajtohet si rrezik i madh per Ameriken, aq sa, ne nje raport te Departamentit te Shtetit, theksohet se rreziku per Ameriken vjen nga vendet me popullsi muslimane Roli i lobit hebrej, per te tmerruar me qellim boten per rrezikun nga Islami eshte teper i madh, sepse ne kete menyre ata arrijne te marin ndhama ne miljarda dollare per te mbuluar krimet dhe terrorin qe po ushtrojne ne Palestine, ku me tanke dhe buldozere po i kthejne ne rrenoja qytetet palestineze. Eshte vete Izraeli qe ve ne pune terrorzmin e tij ndaj muslimaneve ne emer te luftes ndaj terrorizmit veprime keto te sponsorizuara nga vete shteti i tyre. Eshte e papranueshme qe bombat qe shperthejne ne te kater anet e globit t, ia faturojne Al Kaides e cila sipas mediave eshte bere qendra e terrorizmi t'u afrohen atyre qe i luftuan per shkak te fese se tyre dhe qe i debuan nga shtepite e tyre dhe qe i debuan nga tokat e tyre. . Islam do te thote paqe dhe mbi kete baze Ai synon te

vendose Paqen ne te gjithë boten dhe nuk eshte e vertete se islami eshte kunder demokracise. Deklarata se Islami kerkon te vendose nje perendori nga Spanja ne Indonezi eshte nje akuze e rradhes

Qe sot te kete paqe ne bote, duhet te kete paqe ne mes te feve dhe vetem kur fete t'i ulin armet, bota dhe njerezimi do te jene te qete. Po a do ta kete fatin te jetoje njerezimi ne nje paqe te tille

Deri sa te vije ajo dite muslimanit i mbetet detyre qe te lidhet fort pas fese se tij hyjnore dhe te rrezatoje vlerat e fese islame, sepse musliman i vertete eshte ai qe punon per Islamin. Lusim Allahun e Madheruar qe te na beje edhe ne prej ketyre muslimaneve, qe fene islame, kete dhurate hyjnore, ta kemi dhe ta bejme pjesen me te rendesishme te jetes sone

Haxhi Vehbi Dani
Kryetar i Shoqates Bamirese Shkoder Shkoder, me 11. 7. 2007

Lajme nga Bota Islame

Mblodhi: **Mirsad SYLJA**

Përkujtohen viktimat e Srebrenicës

Më datë 13.07.2007, në Bratunas në afërsi të qytetit të Srebrenicës është mbajtur një ceremoni përkujtimore për viktimat e masakrës së hidhur të Srebrenicës.

Sipas gazetës 'Oslobogjenje', botim i Sarajevës mësohet se në këtë ceremoni kanë marrë pjesë edhe disa autoritetet të larta të Republika Serpskas.

Siç dihet më 11 korrik të vitit 1995, ushtarët serbë vranë 8'000 burra myslimanë. Kjo ishte njëra nga gjenocidet më të tmerrshme në Evropë prej përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. Kufomat e 465 viktimave të kësaj masakre (prej rreth 8'000 myslimanëve të vrarë) burra dhe fëmijë të moshës prej 13 deri 77 vjet u varrosen në qendrën memoriale në Potoçari, në afërsi të Srebrenicës, Bosnja Lindore.

Duhet theksuar se kjo masakër u krye në sytë e trupave të OKB dhe deri më tani nuk është dënuar asnjë ushtarë holandezë për mos pengimin e kësaj masakre.

[http:// mesazhi.com](http://mesazhi.com)



Kongresi voton për tërheqje nga Iraku

Dhoma e Përfaqësuesve në Uashington ka votuar në favor të tërheqjes që trupave nga Iraku deri në prill të vitit 2008.

Dhoma e kontrolluar nga demokratët votoi me 223 vota pro dhe 201 kundër për ligjin me shpresën se ai do të rrisë presionin mbi Senatën amerikanë që të vendosë një afat tërheqjeje të ngjashëm në ligjin për ushtrinë që është duke debatuar.

Përpara këtij zhvillimi, presidenti Bush prezantoi një raport të brendshëm lidhur me situatën në Irak, i cili thotë se është bërë vetëm një përparim i vogël ushtarak dhe politik.

[http:// mesazhi.com](http://mesazhi.com)

Princi planifikon të ndërtojë një metropol prej 300 miliardë dollarësh

Princi Fahd bin Sultan, këtë vit do të nis ndërtimin e asaj që ka për qëllim të jetë si një vitrinë ekspozuese e Arabisë së Re Saudite.

Në Mbretërinë e Arabisë Saudite era e ndryshimeve ndihet në ajër. Guvernatori Regjional i Tebukut Princi Fahd bin Sultan, këtë vit do të nis ndërtimin e asaj që ka për qëllim të jetë si një vitrinë ekspozuese e Arabisë së Re Saudite: Të një metropolisi multikulturor që do të kushtojë 300 miliardë dollarë dhe do të joshë 700'000 banorë nga e tërë bota. Ndërtimi i këtij dhe të pesë mega-qyteteve tjera është paraparë të finalizohen nga vitet 2020 dhe do të financohen nga burime të ardhurash nga petroli. Pesë familjet e mëdha në Lindjen e Mesme posedojnë rreth 60 përqind të naftës botërore, dhe Shtëpia e Saudëve kontrollon më tepër se një të tretën e kësaj sasive, bazuar në Robert Baerin, ish oficerin e CIA në Lindjen e Mesme.

Njëri prej këshilltarëve të princit është 30 vjeçari Fahd al- Rasheed, guvernatori i qyteteve ekonomike në Autoritetin Gjeneral të Investimeve të Arabisë Saudite me bazë në Riad, organizatë që qëndron prapa projektit të ri të Tebukut dhe të pesë qyteteve tjera. "Ka shumë kritika kundër nesh" thotë al-Rasheed, i ulur pranë tij në aeroplanin privat në rrugë për tu takuar me princin Fahd është magnati i ndërtimeve dhe arkitekti i Tebukut të Ri, Bahaa Hariri, djali i kryeministrit të vrarë të Libanit, Refik Hariri "Ata janë xhelozë ndaj suksesit tonë" thotë al-Rasheed, i cili ka magjistruar në Administrim të Biznesit në Universitetin e Standfordit. "Spjegimi i planit të Tebukut të Ri është pak kompleks. Aspekti kryesor i kritikave është prurja e njerëzve të cilët do të kuptonin shpirtin tonë dhe kulturën tonë duke jetuar dhe punuar në qytetin e ri."

Sipas planit të Haririt furnizimi i energjisë të këtij megaqyteti në Detin e Kuq do të bëhet përmes energjisë solare dhe turbinave të erës. Do të përmbajë fusha golfi dhe klube jahtash, barabar me zona banimi dhe villa pushimi. Karburanti i lirë Saudi do të furnizojë parqet industriale që do të shtrihen në shkretëtirën vështirë të kultivuar deri tani.

"Do të organizohen kushtet më të larta të jetës dhe të punës." - thotë Hariri. "Interesi i ardhjes së kompanive të huaja këtu do të jetë qasja ndaj naftës së lirë saudite dhe me këtë ata do ta kursejnë 50 përqind të shpenzimeve të tyre."

[http:// mesazhi.com](http://mesazhi.com)

<http://www.bloomberg.com/apps/news?pid=20601088&sid=a6zWE3eTKU4w&refer=home>



Gjashtëmbëdhjetë të vrarë në sulmet e forcave amerikane në lindje të Bagdadit

Të paktën 16 persona janë vrarë në sulmet ajrore dhe tokësore të ushtrisë amerikane në lindje të kryeqendrës irakiane Bagdad.

Ministria e brendshme e Irakut në një komunikatë të saj ka njoftuar se forcat amerikane janë përleshur me grupe të armatosura në rajonin Alamin, ndërkohë që sulmi i helikopterëve amerikanë në këtë rajon ka shkaktuar 16 të vrarë dhe 24 të plagosur.

Në informacione të tjera mësohet për vrasjen e një gazetari të Reuters dhe shoferit të tij, ndërkohë që forcat amerikane nuk e kanë konfirmuar këtë lajm.

[http:// mesazhi.com](http://mesazhi.com)





CEREMONI MADHESHTORE NE MEDREZENE HAXHI SHEH SHAMIA

Ceremonia qe u organizua ne medrezene e qytetit tone per t, u dhene lamtumiren maturanteve te vitit shkollor 2006-2007, sivjet kishte dicka te vecante ne krahasim me vitet e tjera, . sepse te pranishmit dhe te ftuarit paten rastin te shikojne nje organizim te persosur, i cili ishte i pranishem qe tek nje prezantim emocional dhe i sakte i atyre djemve te shkathet qe u prezantuan ne rolin e spikerit, deri tek ajo ceremoni modeste qe e mbylli aktivitetit, ku te ftuarit dhe te gjithë te tjeret e pane vehten ne nje koktej te thejshte, por pse jo edhe te pasur ne asortimente. Ishte hymni i flamurit ai qe dha sinjalin se per te pranishmit do te fllonte te shpalosej pjese- pjese ajo qe kishin pergaditur organizatoret e kesaj shfaqjeje te bukur, ku maturantet po i linin lamtumiren bankave te kesaj shkolle ne deren e se ciles, dikur hyne si femije te ndrojtur, . Tashti, ato po largohen burra per piketuar tashme shkollen e larte, ku dijet do te jene pjesa kryesore e jetes se tyre ne te ardhmen. Kur njeriu i shikon keto nxenes burra, patjeter mendon se cfare moren ato nga kjo shkolle e mrekullueshme dhe e rralle dhe se cfare i dhane ato kesaj shkolle. Duke pare rezultatet e tyre ne procesin mesimor- edukativ, ne ndejme kenaqesi se keto maturante bene te pamunderen qe urdheri i dhene nga Allahu i Madherueshen, ne Kuranin Famelarte permes fjales magjike "Lexo", ' ishte bere prej tyre pjesa me e rendesishme ne jeten shkollore ne medreze. Ishikon keto djem te rinj qe e ndejjene vehten krenare, qe po diplomohen ne kete shkolle, ku ato u pergaditen me nje dije te larte shkencore dhe me nje moral te paster islam. Arritja e ketyre vlerave eshte nje dhurate e madhe, te cilen Allahu i Madherueshem ua ka bere privilegj ketyre maturanteve qe u bene shembull per te gjithë nxenesit e tjere te shkolles. Ishin keto maturante qe sot po i drejtohen medrezese me nje fjale qe te ngjall emocione te fuqishme dhe te paharruara;

"Te falenderojme per dije dhe edukate islame qe morem. Ate, qe ne e leme pa bere, do ta bejne ato, qe do te vijne pas nesh"

'Sapo maturantet do te largohen nga dera e medrezese, ato do ta kuptojne se lane pas nje jete te paperseritshme, qe per ato do te jete nje kujtim i cili gjithmone do te jete pjese e shpirtit te tyre.



Ne podium ata u ngjiten njeri pas tjetrit, duke sjelle per ato qe ishin te pranishem, rezultatet e tyre te cilet i arriten me nje angazhim shembullor dhe te vazhdueshem. . Maldi Domnori konkuroi me sukses, duke siguruar te drejten per te studjuar neper universitet e Italise. Te tjere jane ato qe e kane lartësuar emerine e medrezese Haxhi Sheh Shamia me rezultate te larta ne konkurset ne shkalle rrethi dhe ne shkalle kombetare ne te gjitha lendet. Maturantet e vitit shkollor 2006-2007paten ne mesin e tyre nje emer qe i dha emer vete medrezese me rezultatet e shkelqyera, te arritura ne te gjitha lendet dhe mbi gjithshka ai shkelqeu ne konkurset ne te gjitha shkallet, duke i sjelle trofe medrezese se tij qe ato te jene deshmi e

nivelit te larte mesimor edukativ qe realizohet ne kete institucion shkollor. Quhet Ardit Muca, ky nxenes e rralle, qe per 8 vite, ne medreze, ishte me i miri, jo vetem ne mesime, por ne te gjithë treguesit qe i bejne portretin e nje nxenesi qe rralle shihet neper shkolla. Ishte i vogel ate dite, kur konkuroi per te hyre ne klasen e peste te medrezese dhe pak kujt mund t, I kishte shkuar mendja, se djali i vogel i dikurshem, do te behej krenaria e shkolles, e qytetit dhe e Atdheut, sepse ai tashme eshte pjese e ekipit kombetar qe do te konkuroje ne Vietnam, ne Olimpiaden Boterore te matematikes per shkollat e mesme. Ata, qe e njohin Arditi ne shkolle, e nderojne si fitues te vendeve te para ne olimpiadat qe jane bere ne rreth, ne rang kombetar, ku ai ka shkelqyer ne lenden e matematikes. Por, njeriu habiten, kur merr vesh se Arditi eshte i apasionuar deri ne infinit pas histories dhe lendve shoqerore qe vijne pas saj duke na bindur se Ardit Muca eshte modeli i rralle i nje nxenesi, qe deshiren e tij per te ditur, e ka te shtrire ne shume pista, te cilat dija i ka te pafundme. Jo pa qellim vleren me te cmuar si medrezist te Arditi e kaluam ne fund. Arditi ka fatin e madh, se Allahu i Madherueshem e ka udhezuar si nje besimtar shume te perkushtuar. i rritur ne nje familje fetare, ku ne vecanti nena dhe gjyshi i tij inderuar Hafis Mani, qe nuk jeton me. luajten nje rol shume te rendesishem qe ai, qe i vogel, te njihet me vlerat e fese islame, te cilat tashme jane bere pjesa me rendesishme e jetes se tij Urojme qe Arditi te shperblehet me nje dege studimi e cila do t, I jape mundesi te kape maja edhe me te larta dijeje, qe te kemi nje musliman te ditur, ne shpirtin e te cilit, feja islame te jete vete jeta e tij Duke i uruar Ardit Mucës suksese ne jeten e tij drejt dijeve, ne vazhdojme te percjellim aktivitetin per lamtumiren e maturantave, cila tashme na percjell pamje ku maturante, prinder dhe mesues bejne fotografi, per t, I patur si kujtim nga ky aktivitet i paharrueshem.

Tashme medrezeja i ka mbyllur dyert e saja per t, I hapur perseri ne shtatorin e ardhshem duke pergaditur maturante te rinj, qe stafeten e medrezese ta cojne me tej, qe dija dhe feja te jene ato qe do te bejne portretin e sakte dhe te duhur te medrezstit te medrezese Haxhi Sheh Shamia.

Selim Gokaj

Shkoder me 10 korrik 2007

VAKUFI, PASURI E TE GJITHE MUSLIMANEVE

Kanë kaluar 17 vjet nga koha e rikrijimit të institucionit të KMSH (Komuniteti Musliman Shqiperisë) dhe të organeve të saj të shtrirë në të gjithë territorin e vendit, duke kërkuar të kryejë detyrat ndaj muslimanëve. E gjithë puna organizuese dhe drejtuese mbështetet në rregulla, të cilat janë të përmbledhura në statutin e këtij institucioni. Eshhtë e natyrshme që veprimtaria dhe aktiviteti që zhvillohen nga ky institucion (në përputhje me qëllimin e krijimit të tij) të kërkojnë shpenzime. Të shpenzosh duhet të kesh burime të ardhurash. Të ardhurat e KMSH vijnë nga:

- kuotizacionet;
- donacionet;
- Pasuria ose vakfi.

KMSH si organizatë me antarësi, nuk praktikon kuotën për çdo anëtar ose familje muslimane, formë që do të realizonte të ardhura dhe që ligji këtë e lejon.

Donacionet e ofruara nga subjekte private ose publike, vendase ose të huaja përbëjnë të ardhura, por që nuk do të vazhdojnë pafundësisht. Thëksojmë se për sa kohë që KMSH varet nga financimet e donatorëve, aftësia e tij për të artikulluar interesat e muslimanëve në mënyrë të pavarur do të jenë në rrezik.

Baza e të ardhurave të KMSH është pasuria e trashëguar dhe veprimtaria ekonomike e zhvilluar prej institucionit.

Pasuria e KMSH njihet me emrin VAKUF, term i huazuar nga gjuha arabe, që do të thotë të mos lëshohet.

Kjo është krijuar shumë kohë më parë nga muslimanë bujarë dhe të devotshëm, të lënë me testament në bazë të shariatit, për vepra bamiresie, të dobisë së përgjithshme e sidomos për mbajtjen e funksionimit e institucioneve fetare e kulturore. Si pronë i është bashkëngjitur xhamive, medreseve, bibliotekave, jetimoreve, hamamve etj. Tradita profetike nuk lejon shitje ose tjetërsim të vakfit. Fjala vakuf për moshat e reja është e panjohur për shkak të situatave që kanë kaluar, ndërsa tani në ekonominë e tregut kjo lloj pasurie (troje në qytetet kryesore, në të gjithë gjeografinë e vendit) po lakmohet shumë nga të



pangopur që e shijuan leverdishmërinë e pronës vakuf. Tradicionalisht kjo pasuri e KMSH (në vitin 1923) është administruar nga një zyrë e posaçme, e quajtur Zyra e vakfit dhe tani nga drejtorja e Vakf-investimeve. Drejtorja e vakf-investimeve dhe e financës ngarkohet nga statuti me administrimin e pasurisë dhe me ndermarrjen e studimeve me qëllim rritjen e të ardhurave përmes vënies në efikasitet të saj duke rritur efektivitetin e investimeve.

KMSH, kohë më kohë, për të kapercyer vështirësitë ka gjetur rrugën më të shkurtër duke shitur troje ose duke i tjetërsuar ato. Të gjitha keto veprime kanë një pasojë: zhveshjen nga pasuria dhe lënien në varfëri të KMSH. Shembuj të trajtimit të pasurisë ka plot dhe bindemi që "të drejtën" për administrimin e saj e kanë shpërdoruar ata që kanë obligim për ta ruajtur dhe forcuar atë. Në aktet e kontrollit të ushtruara për myftini ose për KMSH, janë të evidentuara pasuri konkrete dhe veprime (marrëveshje, kontrata e dokumentime), që mbartin dëme të konsiderueshme për KMSH.

Konsiderata të tilla transmetojnë raportin e komisionit të transparencës me kryetar z. Tomorr Ballabani i datës 04/05/2004, informacioni i dhënë mbi kontrollin e kryer në drejtorinë e vakfit, i kryesuar nga z. Skënder Belalla i datës 11/12/2005, raporti i mbajtur në Këshillin e Përgjithshëm nga z. Bujar Topciu (përfaqësues i Krujes) në vitin 2006, raporti i komisionit të transparencës mbi shitje të truallit 1600 m² në qendër të Tiranës të mbajtur në datën 02/06/2007. Gabimi i kryer, pa dashje ose me dashje, nuk bie mbi kokën e atyre që gabuan, por mbi të gjithë muslimanët. Organi vendimarrës KP deri tani nuk ka marrë vendim për shitje ose tjetërsim të pronës. E keqja qëndron se reflektimi ndaj këtyre shfaqjeve është pothuajse zero, trualli përsëri shitet si në rastin e fundit në Tiranë.

Pse ndodh kështu? Mendoj se duhet të ndryshohet mentaliteti në trajtimin e vakufit duke përcaktuar rregulla të qarta në statut qoftë dhe për rastet e emergjencës. Do të ndihmonte problemet komplekse që ka institucioni, nese do t'iu bëhej thirrje

njerëzve të ditur në fusha të ndryshme për të marrë mendimin e tyre (si grupe këshillimore) dhe për vakfin pa tjetër duhet të vlerësohet mendimi i myftinisë, ku bëjnë pjesë pasuria si përfaqësuesi i parë i saj dhe i formimit të saj.

Një nga rrugët për të rritur të ardhurat është veprimtaria ekonomike që deri tani kanë qënë kontratat e dhënies me qera të objekteve, e cila përbën veprimtari pasive. Do të ishte me efekte më të mëdha në rritjen e të ardhurave të KMSH, një veprimtari active, që kërkon më shumë impenjim, fantazi, devotshmëri dhe për të zhvilluar një gjë të tillë ka hapësira ligjore. Në këtë fushë mund të përmendim:

- organizimin e agjensive funerale në qytete kryesore (eksperiencat kanë qënë deri në vitet 1960);
- organizimin e shtypshkrimeve islame në një qendër, mbasi përkthehet literaturë, botohen gazeta (në Shkodër ka tri të tilla);
- aktivitete shërbimesh që janë të lidhura me të lejuarën e të palejuarën;
- krijimin e qendrave shëndetsore.

Nuk mund të justifikohet KMSH, pasaniku që vjen mbas shtetit siç thuhet nën zë, për mungesë fondesh: për të pasur nivel shumë të ulët pagash ndaj imamve, në vështirësitë për mirëmbajtjen e objekteve të kultit, në mos zhvillimin e aktiviteteve aq të nevojshme me rininë etj etj, madje shkohet deri aty sa titullari merr rrugët jashtë shtetit për t'iu kërkuar donatorëve fonde për rrogat e punonjësve të institucionit.

Të çudit fakti që Kryesia e KMSH dhe ajo e Këshillit të Përgjithshëm, nuk e ka pa të arsyeshme të trajtojë në mbledhje të veçantë gjendjen e pasurisë të vakfit, si është shfrytëzuar ajo, çfarë objektivash duhet të arrihen, aq më tepër kur një mbledhje e tillë u është kërkuar zyrtarisht të dy kryesive. Nuk mund të justifikohen duke thënë se problemet e pronës i kemi diskutuar me myftijtë dhe ekonomistët, duke pohuar edhe se ne jemi KP.

Eshtë për të ardhur keq se shërret më të mëdha në KMSH kanë ndodhur vetëm për shkak të PRONES, siç janë Zdrallë në Shkodër, lulishta 1 Maj në Durrës, sheshi pranë bustit të A. Hajdarit në Tiranë, Namazgjaja në Elbasan etj etj. dhe pasojat (përveç dëmeve ekonomike) janë të larguarit ose të dorëhequrit nga strukturat e KMSH, të kuadrove të arsimuar jashtë vendit.

Eshtë imperative për kohën që kalojmë, të vendosim në pozita të shëndosha drejtuesit e vakufit, që ta trajtojnë, ruajnë dhe shfrytëzojnë në mënyrë të drejtë këtë pasuri, që të parët na e kanë lënë amanet. Të gjithë duhet të ndërjegjësohemi për vakfin, në këtë mënyrë jemi falenderues ndaj Zotit të madhëruar. Ata që e kanë barrë këtë punë duhet të reflektojnë në radhë të parë, duke korigjuar atë që sot mund të rregullojnë, të përpilojnë rregulla e kritere të qarta, së pari në letër dhe pastaj në veprim.

Dhe kjo kërkon muslimanë të devotshëm, dhëntë Zoti të na udhëzojë të gjithëve në rrugë të hajrit.

Falenderoj Zotin për mirësinë e gazetës BESIMTARI, që na jep hapësirë për të shprehur mendimet tona dhe me këtë rast uroj që Ai t'i japin sukses.

Ing. Hadi Bushati
Anëtar i Këshillit të Përgjithshëm
Shkodër, 7 Qershor 2007

VDEKJA NA VJEN PREJ KADARESE SE TILLE

Ne filim te viteve 90, ishte ne mode te rreshtohesh kunder muslimaneve shqiptare dhe te beje propogande katoliko ne dem te shumices shqiptare dhe ne kete linje u rrallit per pak kohe edhe akademiku kosovar, Rexhep Qosja, por qe me vonë ai i pa realitetet historike dhe kulturore e fetare te shqiptarve duke sqaruar gjere e gjate aresyet e evulimit te tij drejt te vertes ne drejtim te pasqyrimin me realitet te identitetit te shqiptarve. Përballe reflektimit te akademikut kosovar, shkriktari i kohes se komunizmit ne Shqiperi Ismail Kadare nuk pranon se ka penalizuar bashkombasit e tij muslimane te cilet i ka quajtur nje turme fodujsh harrestare. Te gjithë njerezit gaboje, por me i miri ne mes te tyre eshte ai qe pendohet - ka thene Profeti yne i nderuar, Muhamedi a. s. Kurse, Kadareja, nuk ka bere kurrfare pendese per bemat e tij shume here skandaloze por po lufton me cdo kusht qe te ruaj shenjterine e tij, sidoms po behet cope qe te rrembeje cmimin Nobel.. Dhe per ta bere te tijin kete cmim, ai po lot nje numur te pafund kartash te cilat pa tjetër po e rendojne figuren e tij ne opinjonin publik. Shume e trishtueshme eshte sidomos karta e antiislamikut te cilen e futi ne loje, sapo e pa se tashme kishte filluar nje kryqzate e tmerrshme kunder shumices muslimane te popullit te tij, duke shpresuar se karta antiislamiqe, qe po hidhte para opinjonit publik, do t, i jepte suksesin. Ne nje interviste te dhene per televizorin Klan, ai u kujtoi telespektatoreve se ne vitin 1989 i kishte thene Ramiz Alise qe per ta demokratizuar Shqiperine dhe per ta sjelle ate me prane Evropes, duhet te hapen kishat katolike dhe kishat ortodokse, qe sa me shpejt te zbehej identiteti musliman i shqiptarve. Ky veprim ishte vetem fillimi i luftes kunder bashkombasve te tij muslimane. Edhe gjate viteve 90, ky poet politik qe po vepron kunder muslimaneve shqiptare, kishte deklaruar haptas opozicionin e tij ndaj identitetin musliman te shqiptarve, duke duke deklaruar ne menyre te turpshme se muslimanet ne Shqiperi jane pakice. Duket se per Kadarene dhe shume te tjere si Kadareja, muslimane jane vetem ato qe shkojne ne xhami, kurse te tjeret jane jashte fese islame Eshte ky Kadare qe u binte burive te

alarmit se Evropa nuk i mirepret muslimanet ne gjirin e saj per sa kohe ato nuk kthehen ne te krishtere. Eshte ky Kadare qe bente te piste lidhjet e kultures shqiptare me islamit Ne nuk do te harrojme nje interviste te Kadarese qe i dha agjensise Kosova Press, ku theksoi se shumica e te arsimuarve ne Shqiperi jane te krishtere duke u bere nje portret te shemtuar muslimaneve, qe per kete Kadare Jane njerez tuafe dhe matufe te pashkolluar, mendim ky shume dashkeqes dhe aspak i vertete Ajo qe eshte me e rrezikshem me keto deklarata eshte se ai konfirmoi lidhjen e tij me shtabe te errta antimuslimane mrenda Shqiperise dhe jashte kufinjve te saj.

Nuk eshte e qarte se kush i pat dhene urdher Kadarese qe t, I quante luftetaret e UCK terroriste, te cilet, po ky Kadare, kuptohet me urdher, do t, i ngrinte ne qiell heroizmat e tyre duke u afirmuar se per, kariere dhe per nje Nobel, pranon te behet marionete ne duar te armiqve te Shqiperise dhe te Islamit

Kur, Kadareja e shikoi se me deklarata antiislame nuk mund te fitohet Nobeli, sepse ate po e fitojne shkencatare dhe figura te tjera muslimane dhe kur e shikoi se Shqiperia nuk mund te zgjohet e krishtere, me dy ose tri deklarata beri perpjekje te varroste ato qe pat thene kunder muslimaneve, por pa kerkuar asnjehere falje per ato klithje kukuvajke.

Edhe ne Kosove, bemat e Kadarese ne dem te interesave te muslimaneve, nuk kane munguar. Kadareja do te firmose nje peticion per te shpejtuar ndertimin e katedrales ne Prishtine, duke harruar te ngreje zerin per nje xhami te madhe ne Prishtine dhe ne Shqiperi, ku besimtarete po falen neper rruge, ne shi dhe ne bore.

Qendrimet e tilla, qe po mban Kadareja, jane me te rrezikshme se vete komunizmi, sepse vdekja e shqiptarve vjen nga nje mentalitet i tille dhe shqiptarve nuk do t, u benin dobi as 100 cmime Nobel per antivlera te tilla antihumane si keto qe Kadareja ka vendosur t, ua transmetojte bashkombasve te vet muslimane.

HALIL IBRAHIMI

. Pedagog ne Universitetin e Prishtines

Bordi drejtues dhe bashkëpunëtorët e gazetës

**Vehbi Dani
Olsi Jazexhiu
Selim Gokaj
Bashkim Bajraktari
Hysen Kazazi**

**Faqosja:
Gazjon Rusi
Radhitja:
Ditmir Gokaj**

www.gazetabesimtari.com

بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِیْمِ

Bismil-lahi Rrarhmanirr-rrahim

Klientë të nderuar! Vëllezër dhe motra muslimane, market "ISMETI" ju garanton:

- 1- *Produkte mishi hallall si: sallam, suxhuk,*
- 2- *Pizeri hallall*
- 3- *Fast Food hallall*

Adresa: Pranë teatrit "MIGJENI"
Cel: 0692101893



EJANI TEK NE! FABRIKA E PERPUNIMIT
TE DRURIT

ILIRIA

me pronar Haxhj Ilir Muja (aktivist dhe bamiress Islam), ju afrohem prodhime nga me" të thjeshtat deri ne dhoma gjumi. Shërbehet ne kohe dhe me cilësi të larte:

- Prodhim dyer e dritare
- Dhoma gjumi
- Pajisje zyresh
- Pajisje kuzhine
- Dhoma fëmijësh

Pajisje për ambiente lokalesh
Te gjitha këto me çmime konkurruese dhe me transport të garantuar falas. Ejani në fabrikën tone dhe do te mbeteni te kënaqur. Mund te kontaktoni me numrin e mobilit: 0692523565

